



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 prill 2021
Nr.ref.:RK 1758/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI10/21

Parashtrues

D.P.H “DENI” me pronar Asdren Salihu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.
1129/2019, të 16 nëntorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga D.P.H “DENI” me seli në Podujevë me pronar Asdren Salihu, (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Gani Asllani nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 1129/2019, të 16 nëntorit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 11 janar 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), e të cilën kjo e fundit e pranoi më 13 janar 2021.
6. Më 18 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 22 janar 2021, Gjykata (i) e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës; dhe (ii) kërkoi nga përfaqësuesi dorëzimin e autorizimit që dëshmon se po e përfaqëson parashtruesin e kërkesës pranë Gjykatës.
8. Më 15 shkurt 2021, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës autorizimin përkatës.
9. Më 18 shkurt 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 13 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Marrëveshja mbi kredinë dhe ristrukturimi i saj

11. Më 18 shtator 2007, parashtruesi i kërkesës së bashku me dy garantues (B.S dhe N.S), lidhi një Marrëveshje mbi Kredinë nr.200631530 (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja mbi Kredinë) me Bankën Raiffeisen (në tekstin e mëtejme: Kreditori) në shumën prej 30.000 Euro. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës kishte nënshkruar dhe Shtojcën 1 për pengun dhe një marrëveshje lidhur me hipotekën.
12. Më 27 shkurt 2009, parashtruesi i kërkesës dhe kreditori nënshkruan Shtojcën 2 për ristrukturimin e kredisë, përkatësisht Marrëveshjes së Kredisë së 18 shtatorit 2007, në shumën prej 24. 244,49 Euro. Në Shtojcën 2, u përcaktuan afatet e reja për kthimin e kredisë dhe përcaktim i ri i përqindjes së kamatës. Nenet tjera specifike të Marrëveshjes mbi Kredinë të 18 shtatorit 2007 mbeten të pandryshuara.

Procedura tjera të iniciuara nga parashtruesi i kërkesës, sipas shkresave të lëndës

13. Sipas shkresave të lëndës, më 24 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës ka ngritur padi për “*anulimin e borxhit të pa-kontraktuar*” pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Ekonomike (numrin e lëndës I.C.nr.227/17).
14. Bazuar në shkresat e lëndës, më 24 qershor 2015, poashtu, parashtruesi i kërkesës iu ishte drejtuar policisë së krimeve ekonomike, lidhur me çështjen e kredisë së tij.
15. Më 28 gusht 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, përmes një Aktvendimi ka miratuar propozimin e parashtruesit të kërkesës që në këtë çështje kontestimore të nxirret një ekspertizë, lidhur me transaksionet e kryera nga kredia.
16. Lidhur procedurat e lartcekura, Gjykata nuk ka informacione tjera.

Propozimi për përmbarim dhe procedura përmbarimore

17. Më 10 korrik 2017, Kreditori, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk iu është përmbaritur marrëveshjeve të sipërcituara (shih paragrafët 11 e 12), parashtruesi propozoi përmbarim tek përmbaruesi privat me sekuestrim kolaterali si dhe me shitjen, zbrazjen dhe dorëzimin në pronësi dhe posedim të paluajtshmërisë. Kreditori kërkoi nga Përmbaruesi Privat të: (i) lejohet përmbarimi dhe të detyrojë parashtruesin e kërkesës të bëjë pagesën e shumës prej 29,346.94 Euro; (ii) të bllokohen të gjitha llogaritë nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të gjithë debitorëve duke bërë pagesën me bartje të mjeteve; (iii) të sekuestrohet kolaterali; (iv) të lejohet përmbarimi sipas propozimit të kreditorit, me shitjen, zbrazjen dhe dorëzimin në pronësi dhe posedim të paluajtshmërisë.
18. Më 11 korrik 2017, Përmbaruesi Privat me Urdhërin Përmbarimor [P.nr. 313/2017], lejoi përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

19. Më 19 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi prapësim kundër Urdhërit përmbarrimor [P.nr. 313/2017], të cilin e plotësoi me parashtrësën e datës 4 dhjetor 2017. Parashtruesi i kërkesës në prapësim, theksoi se: (i) i ka përmbushur të gjitha detyrimet e kredisë, me ç' rast i ofroi gjykatës pasqyrën e pagesave të llogarisë bankare; (ii) pretendoi se kreditori në mënyrë të kundërligjshme ka ushtruar shumën prej 29,346.94 Euro, dhe e ka mashtruar parashtruesin e kërkesës me një *“plan të kundërligjshëm të amortizimit duke u bazuar në produkt të ashtuquajtur “Ballon payment”*; dhe (iii) theksoi se sipas nenit 262 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), çështja përmbarrimore nuk mund të vazhdojë sepse ekziston gjyqvarësia (litispedenca) në këtë çështje juridiko-civile, dhe për më tepër deklaroi se në këtë çështje është duke u zhvilluar procedurë hetimore për delikt ekonomik.
20. Në një datë të pacaktuar, Kreditori poashtu parashtrroi përgjigje në prapësim dhe ndër të tjera theksoi se (i) ristrukturimi kredisë bëhet gjithmonë me kërkesë të debitorëve dhe ku kredimarrësi dhe kredidhënësi pajtohen me kushtet e reja; (ii) konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore që të vazhdohet procedura përmbarrimore, dhe debitori ka për qëllim vetëm zvarritjen e lëndës.
21. Më 15 janar 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë –Dega në Podujevë (në tekstin mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktvendimit [PPP.nr.62/2017], refuzoi si të pabazuar prapësimin e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Themelore fillimisht theksoi se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se çështja përmbarrimore nuk mund të vazhdojë sepse ekziston gjyqvarësia, thekson se nuk qëndron, dhe i referohet nenit 35 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (në tekstin e mëtejme LPP) i cili përcakton *“Organi përmbarrues nuk mundet të ndërpres procedurën përmbarrimore me qëllim që të pres vendimin e Gjykatës kompetente, apo të ndonjë organi tjetër për çështjen paraprake”*. Gjykata Themelore gjithashtu arsyetoi se asnjë provë siç kërkohet me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së nuk është dorëzuar, dhe se Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës i 18 gushtit 2007, paraqet titull ekzekutiv siç parashihet me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.7 të LPP-së. Gjykata Themelore poashtu i referohet nenit 27 paragrafi 1 sipas të cilit përcaktohet se çka nënkupton dokument përmbarrimor.
22. Në një datë të pacaktuar, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.62/2017], parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar: (i) shkelje të dispozitave ligjore; (ii) konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës së pari në ankesën e tij konsideron se ka ofruar prova përkatëse për gjykatën, konkretisht 1. pasqyrën e llogarisë për pagesat e bëra; 2. Planin e amortizimit të bankës; 3. Shkresat zyrtare drejtuar kreditorit dhe 4. Kërkesës e drejtuar policisë së krimeve ekonomike të datës 24 qershor 2015. Parashtruesi i kërkesës së dyti, thekson se sipas nenit 352 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejme: LMD), kërkesa për përmbarrim është parashtruar sipas afatit 5 vjeçar, sepse kredia është lidhur në vitin 2007 dhe sipas nenit 379 të LMD-së, ndalohet kamata në kamatë.
23. Më 16 nëntor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.1129/2019], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit

theksoi: (i) lidhur me pretendimin ankimore se të gjitha detyrimet ndaj kreditorit janë përmbyllur, e konsideroi si të pabazuar sepse edhe pse parashtruesi i kërkesës ka realizuar disa pagesa, dhe fakti që bilanci në fund të pasqyrës së llogarisë bankare i nxjerrë më 22 mars 2015 rezulton të jetë 0.00 Euro, nuk nënkupton që kredia është paguar në tërësi, dhe kjo sipas gjykatës së Apelit është për arsye që pasqyra e llogarisë përmban çdo veprim bankar, përfshirë pagesat, deponimet dhe tërheqjet, që nuk kanë të bëjnë me kredinë në fjalës; (ii) sa i përket pretendimit parashkrimit lidhur me nenin 352 të LMD-së, Gjykata e Apelit theksoi se këtë pretendim nuk mund ta shqyrtojë konform nenit 17 të LPP-së, sepse në shkresat e lëndës konkludohet se debitori prapësimin lidhur me parashkrimin e ka paraqitur vetëm në ankesën e parashtruar; dhe (iii) sa i përket pretendimit se në rastin konkret është aplikuar kamata mbi kamatë, Gjykata e Apelit arsyetoi se në marrëveshjen për kredinë është kontraktuar kamata e rregullt prej 14%, dhe e cila në ristrukturimin e kredisë është kontraktuar në 16%, dhe sipas nenit 4 paragrafi 1. Pika e) e kontratës bazë të kredisë, dhe që vlen edhe për ristrukturimin e kredisë, është kontraktuar dhe pagimi i kamatëvonesës kontraktuese. Në fund, sa i përket çështjes lidhur me lëndën kontestimore, I.C.227/2017, Gjykata e Apelit theksoi se nuk mund ta marrë parasysh në këtë procedurë, sidoqoftë, në rast se parashtruesi i kërkesës i vërteton ato pretendime me vendim të formës së prerë, i njëjti ka të drejtën e inicimit të procedurës së kundërpërmbarrimit konform nenit 54 të LPP-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar, përkatësisht Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 1129/2019, të 16 nëntorit 2020, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
25. Parashtruesi i kërkesës thekson: *”Edhe përkundër pagesës së tërësishme të borgjit kontraktues kreditori [...]ka ushtruar propozim për përmbarrim në shumën prej 29,346. 94 Euro.[...]Sipas pasqyrës së llogarisë bankare të dt. 20.03.2015 shihet se debitori D.P.H “Deni“ ka paguar të gjitha këstet e kredisë në shumë prej 402-3 Euro në muaj, 72 muaj sipas marrëveshjes për ri-programim.”*
26. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *“Ka përmbyllur në tërësi detyrimet ndaj kreditorit [...] sipas marrëveshjes për ri-programim të kredisë dhe konsideron se vendimet e gjykatave në procedurën e përmbarrimit janë të njëanshme dhe dëm të debitorit, andaj mendon se është shkelur parimi kushtetues për gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm”.*
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“të vërtetohet se ka shkelje të parimit për gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm në dëm të debitorit[parashtruesit të kërkesës]”.*

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 22

Dokumenti përmbarues

1. Dokumente përmbaruese janë:

[...]

1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;[...]

Neni 27

Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor

1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.[...]

Neni 35
Ndërprerja e procedurës

1. Organi përmbarues nuk mund ta ndërpres procedurën përmbarimore me qëllim që të presë vendimin e Gjykatës kompetente, apo të ndonjë organi tjetër për çështjen paraprake.[...]

Neni 54
Shkaqet për kundër përmbarim

1. Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbarimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbarimi, të kërkojë nga Gjykatanxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarimit, në qoftë se:

1.1. dokumenti përmbarues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik;

1.2. aktvendimi apo urdhri për përmbarim me anë të vendimit të formës së prerë është anuluar apo ndryshuar;

1.3. gjatë kryerjes së procedurave përmbaruese, kreditori ka marrë më shumë sesa vlera e kredisë, përfshirë kostot e përmbarimit dhe kamatat;

1.4. përmbarimi i kryer në një objekt specifik të përmbarimit është i palejuar.

2. Në qoftë se kreditori me anë të përmbarimit e ka realizuar një shumë të hollash, debitori në propozimin për kundër përmbarim mund të kërkojë pagimin e kamatëvonesës që nga dita e pagimit të shumës së tillë.

3. Propozimi për kundër përmbarim nga paragrafi 1. i këtij neni mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita në të cilën debitori ka marrë dijeni për shkakun e kundër përmbarimit por jo më vonë se një(1) vit nga dita e përfundimit të procedurës përmbarimore.

4. Pas skadimit të afatit nga paragrafi 3. i këtij neni, debitori nuk mund të fillojë kundër përmbarimin, por duhet të fillojë procedurën kontestimore për kërkesën e tij.

Neni 69
Prapësimi kundër vendimeve për përmbarim

[...]

4. Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.[...]

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Neni 352
Afati i përgjithshëm i parashkrimit

Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.

Neni 379
Ndalimi i kamatës në kamatë

1. Në kamatën e kontraktuar e cila ka arritur për pagesë, por nuk është paguar nuk rrjedh kamatëvonesa, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.
2. Është nule dispozita e kontratës me të cilën parashikohet kamatë në kamatën e cila ka arritur për pagesë por nuk është paguar.
3. Megjithatë, palët mund të pajtohen që më parë në kontratë se shkalla e kamatës do të jetë më e lartë në rast se debitori nuk i paguan kamatat e rrjedha për pagesë në kohën e duhur.
4. Në shumën e papaguar të kamatës mund të kërkohet kamatëvonesa vetëm nga dita kur gjykatës i është paraqitur kërkesa për pagimin e saj.

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Ekzistimi i gjyqvarësisë (Litispendenca)

Neni 262

- 262.1 Gjyqvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia.
- 262.2 Sa i përket kërkesës të cilën pala e ka parashtruar gjatë zhvillimit të procedurës, gjyqëvarësia krijohet në momentin në të cilin është njoftuar pala kundërshtarë për kërkesën e tillë.
- 262.3 Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë.
- 262.4 Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
30. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe shih rastin KI26/19, parashtrues *Xhavit Thaqi Pronar i kompanisë "NTP INTERBAJ"*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 tetorit 2020, paragrafi 56).
32. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin Ac.nr.1129/2019 të 16 nëntorit 2020 të Gjykatës Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

35. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Rrjedhimisht, bazuar në specifikat e rastit konkret, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuzë dhe të paqarta”*. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 prillit 2020 ; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 275 deri më 304).
37. Gjykata fillimisht kujton se parashtruesi i kërkesës ka nënshkruar Marrëveshjen e Kredisë me Bankën Raiffeisen. Me rastin e ristrukturimit të kredisë, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur me bankën marrëveshje të re (Shtojcën 2) e cila parashihte kushte të reja kamatës dhe afatit. Për arsye të mos përmbajtjes së marrëveshjeve, banka përkatësisht Kreditori, kishte kërkuar nga Përmbaruesi Privat të lejojë përmbarimin përkatës kundrejt parashtruesit të kërkesës. Përmbaruesi Privat përmes Urdhrit Përmbarimor [P.nr. 313/2017] kishte lejuar përmbarimin të cilin përmes prapësimit e kishte atakuar parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi i kërkesës ndër të tjera përmes prapësimit të tij kishte prezantuar dhe çështjen e pasqyrës së llogarisë bankare, bilanci i së cilës më 25 mars 2015 atij i kishte rezultuar të jetë 0.00 Euro. Gjykata Themelore, i kishte arsyetuar parashtruesit se ai nuk kishte bashkangjitur prova, ndërsa pas procedurës së ankesës, Gjykata e Apelit kishte theksuar se fakti që pasqyra e llogarisë bankare paraqitet me 0.00 Euro, nuk nënkupton se kredia është paguar në tërësi. Rrjedhimisht, kjo e fundit është dhe esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës pranë Gjykatës.
38. Lidhur me rastin konkret, Gjykata gjithashtu ka kuptuar nga shkresat e lëndës se parashtruesi i kërkesës ka filluar dhe procedura tjera lidhur me çështjen e kredisë së tij (Shih paragrafët 13-16 më lart). Mirëpo, Gjykata marrë parasysh që

parashtruesi i kërkesës pranë nesh po e konteston vetëm procedurën përmbartimore, atëherë objekt vlerësimi janë vetëm vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta në këtë procedurë. Gjykata nuk do lëshohet në elaborimin e procedurave tjera të ndjekura nga parashtruesi i kërkesës.

39. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pranë gjykatave të rregullta kishte pretendime të ndryshme të ndërlidhura edhe me procedurat e lartpërmendura, megjithatë ai pranë Gjykatës ka një pretendim të vetëm. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *“vendimet e gjykatave në procedurën e përmbartimit janë të njëanshme dhe dëm të debitorit, andaj mendon se është shkelur parimi kushtetues për gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm”* kjo sepse ai konsideron se *“Ka përmbyllur në tërësi detyrimet ndaj kreditorit”*, bazuar në pasqyrën e llogarisë bankare të datës 20 mars 2015. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij gjykatat e rregullta i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, pasi që nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike.
40. Gjykata fillimisht thekson qëndrimin e saj konsistent se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me mënyrën sesi gjykatat e rregullta kanë bërë konstatimet e gjendjes faktike dhe interpretimet përkatëse ligjore (ligjshmëria) përveç dhe për aq sa interpretimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo nuk mund të vlerësojë arsyen që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim, në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata Kushtetuese do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis* rastet e Gjykatës KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për Papranueshmëri i 12 dhjetorit 2011; dhe shih KI144/18, parashtrues: *Jashar Krasniqi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 9 dhjetorit 2020).
41. Lidhur me pretendimin konkret të parashtruesit të kërkesës pranë Gjykatës, për faktin e pasqyrës së llogarisë bankare, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit PPP.nr.62/2017 të 15 janarit 2019, i kishte sqaruar parashtruesit të kërkesës si në vijim:

“Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit i parashtruar me datën 19.07.2017, kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.313/17 të 11.07.2017, është i pabazuar, ngase nuk ka ofruar asnjë provë në bazë të nenit 69 par 4 të LPP-së ku përcakton se: “Baza për prapsim duhet të mbështetet në prova të duhura. Provat për prapsim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do refuzohet”, po të ishte dorëzua ndonjë provë siç kërkohet me nenin e lart cituar gjykata do kishte vendosur të kundërtën me atë që ka vendos në dispozitivin e këtij aktvendimi.”

42. Për më tepër, dhe Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj Ac.nr. 1129/2019 të 16 nëntorit 2020 kishte arsyetuar se:

“Lidhur me pretendimin ankimor te debitorit se të gjitha detyrimet ndaj kreditorit janë përmbyllur çka shihet nga pasqyra e llogarisë për pagesat e bëra nga debitori. kjo Gjykatë konsideron se një pretendim i tillë nuk është i bazuar, ngase nga shkresat e lendes shihet se debitori me të vërtet ka realizuar disa pagesa lidhur me kredinë e marre, megjithatë fakti se bilanci në fund të pasqyrës së llogarisë, dhe atë me date 20.03.2015, rezulton të jetë 0.00 € nuk nënkupton se kredia është paguar në tërësi, dhe atë nisur nga fakti se pasqyra e llogarisë përmban çdo veprim bankar te cilën debitori e ka ndërmarre gjate periudhës për të cilën është lëshuar pasqyra e llogarisë bankare, përfshire këtu edhe pagesat, deponime e tërheqjet, të cilat nuk kane te bëjnë me kredinë ne fjalë.”

43. Gjykata verën se pretendimi ankimor lidhur me pasqyrën e llogarisë bankare cila ka reflektuar pagesat e parashtruesit të kërkesës në cilësinë e debitorit është trajtuar nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit. Së pari, Gjykata Themelore, i kishte arsyetuar parashtruesit të kërkesës se prapësimi nuk lejohet sepse sipas LPP-së, konkretisht nenit 69 paragrafi 4, baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura, dhe të cilat parashtruesi i kërkesës nuk i kishte dorëzuar. Së dyti, Gjykata e Apelit, kishte sqaruar se fakti që bilanci në fund të pasqyrës së llogarisë bankare rezulton të jetë 0.00 Euro, nuk nënkupton që janë përmbyllur obligimet nga kredia, dhe kjo sepse pasqyra e llogarisë bankare përmban dhe veprime të tjera bankare.
44. Më tej, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte ngritur në procedurën përmbartimore në gjykatat e rregullta dhe çështjen e zhvillimit të procedurës kontestimore mes atij dhe Bankës, për të cilën kishte argumentuar se procedura përmbartimore nuk mund të vazhdojë për shkak të saj. Përderisa ky pretendim nuk është i ngritur nga parashtruesi i kërkesës pranë nesh, Gjykata e konsideron të rëndësishme të trajtojë këtë çështje meqenëse ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ai *“Ka përmbyllur në tërësi detyrimet ndaj kreditorit[...].”*
45. Lidhur me këtë pikë, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj Ac.nr. 1129/2019, ishte përgjigjur si në vijim:
- “Sa i përket pretendimeve lidhur me lëndën kontestimore që është duke u zhvilluar mes palëve nën shenjën I.C.nr.227/2017, dhe ekspertizës së realizuar në këtë procedurë, me datë 14.07.2017 nga eksperti financiar [...] i caktuar nga Gjykata Themelore [...] me aktvendimin e datës 28.08.2017, kjo gjykatë konsideron se përderisa nuk ka një vendim të formës së prerë në procedurë kontestimore, këto pretendime nuk mund t’i marrë parasysht në këtë procedurë, dhe në rast se debitori me sukses i vërteton pretendimet e tij me vendim të formës së prerë, i njëjti ka të drejtë të iniciojë procedurë të kundërpërmbartimit konform nenit 54 të LPP-së.”*
46. Me këtë rast, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka mundësinë e kundërpërmbartimit, në rast se ka një vendim të formës së prerë në procedurë kontestimore, dhe e cila ia lejon atë.
47. Rrjedhimisht, bazuar në të lartcekurat, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla

nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih rastet e Gjykatës: KI101/19, me parashtrues *Ljubiša Trajković*, Aktvendim për Papranueshmëri i 4 dhjetorit 2020, paragrafi 43; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).

48. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
49. Marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta në mënyrë të mjaftueshme kanë trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe të njëjtat nuk kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës për vërtetimin e gabuar të fakteve përkitazi me pasqyrën e llogarisë bankare, Gjykata të njëjtat i kualifikon si pretendime që bien në kategorinë e “*mungesës së dukshme ose evidente të shkeljes*”, dhe i konsideron si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
50. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 dhe paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 21.4 dhe 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 13 prill 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi